



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, **29.05.2019**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.05.2019 të parashtruar nga OE "EURO FAMIS" SHA, nga Suhareka, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndertimi i rrugës në Lugmir - lagja Prishtina e Re, me Nr. të Prok: 616-19-2061-5-2-1 dhe numër të brendshëm 616 19 068 521** nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE **EURO FAMIS " SHA, nga Suhareka** të dt. 27.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ndertimi i rrugës në Lugmir - lagja Prishtina e Re, me Nr. të Prok: 616-19-2061-5-2-1 dhe numër të brendshëm 616 19 068 521**, kundër *Njoftimit për tenderuesin e eliminuar*, të datës 23.05.2019.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin* **Ndertimi i rrugës në Lugmir - lagja Prishtina e Re, me Nr. të Prok: 616-19-2061-5-2-1 dhe numër të brendshëm 616 19 068 521**, sipas rregullave të LPP dhe rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

**OE: "EURO FAMIS" SHA, nga Suhareka** me datë 27.05.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndertimi i rrugës në Lugmir - lagja Prishtina e Re, me Nr. të Prok: 616-19-2061-5-2-1 dhe numër të brendshëm 616 19 068 521**. Autoriteti Kontraktues, me datë 29.05.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ju njofton se me datën 23.05.2019 ju ka derguar letren standarde për eliminim ku është dhen qarte aryeja e eliminimit nga ky aktivitet i Prokurimit. Deklarata juaj se koka terheqese ka fuqi per me shume se 10 m3 e deshmuar me foto dhe libreze te qarkullimit, eshte ne kundërshtim me kerkesat teknike Ne Njoftimin per Kontrate dhe

ne Dosjen e Tenderit pika 9.1&9.2 dhe ne kundërshtim me ate se çka shënon ne Librezen e Qarkullimit te kamionit qe ju keni ofruar si deshmi.

Ne Kriteret teknike dhe ne Dosjen e Tenderit pika 9.1&9.2 eshte kerkuar qe kamionet te jene minimum 10 m3. Libreza e qarkullimit me nr. 04-340-GT qe ju keni ofruar si deshmi deshmon se ky kamion nuk eshte koke terheqese dhe se eshte me peshe maksimale te ngarkeses se lejuar 4950 qe do te thot afersishte 5 m3, andaj edhe AK eshte bazuar dhe bazohet ne ate se çka shënon ne deshmitë e ofruara.

AK – komisioni i vleresimit, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbështetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato qe u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit